

KONTRATË SHIT – BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 22/11/ 2019 “Data e Nënshkrimit”, u lidh kjo Kontratë për Shit-Blerjen e Kuotave “Kontrata”

Ndërmjet:

- **Flavieta BALA**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë (Shqiperi) më datë 20/04/1980 dhe me vendbanim ne Tirane, Shqiperi, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e e Kartës së Identitetit me Nr. 029988440 dhe numër personal I05420213M,Ortake në shoqërinë Eco Car Wash Albania;

Dhe

- **Marko BRINJA**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë (Shqiperi) më datë 27/01/1996 dhe me vendbanim ne Vlorë, Shqiperi, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Kartës së Identitetit me Nr. 032728366 dhe numër personal J60127086E, Ortak në shoqërinë Eco Car Wash Albania;

Të dy sëbashku ortakë në shoqërinë i Eco Car Wash Albania Shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar prane QKB-se dhe e identifikuar nepermjet Nipt. L91425020M, me seli në në adresën Njesia Administrative Farkë, Rruga Shyqyri Brari, Pallati 11, Kati minus 1, Tiranë,

këtu e më poshtë në këtë Kontratë referuar sëbashku si “SHITËSIT” ose Pala Shitëse, përgjegjës për ekzekutimin e kësaj kontrate për të cilën kanë rënë dakort

Dhe

- **Z. Greg XHILLARI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 16.01.1997, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. BJ0963309 dhe Nr. Personal J70116061L;

këtu e më poshtë në këtë Kontratë referuar si “BLERËSI” ose Pala Blerëse, përgjegjës për ekzekutimin e kësaj kontrate për të cilën kanë rënë dakort.

Të cilët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë vijon:



NENI 1

PËRKUFIZIME

1.1 Përveç termave të tjera të perkufizuara posaçërisht në ndonjë dispozitë të kësaj Kontrate, për qëllimet të interpretimit dhe zbatimit të saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Kontratë”	do të thotë kjo Kontratë për Shit-Blerjen e Kuotës, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme dhe anekset e pranuar, nënshkruara dhe shkëmbyera ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;
“Data e Transferimit”	do të thotë data në të cilën kuota transferohet nga Shitësi tek Blerësi, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate, që është dita e nënshkrimit të kësaj Kontrate;
“Pala”	do të thotë Shitësi ose Blerësi ose të dy sëbashku, siç e kërkon përmbajtja e kësaj Kontrate;
“Shoqëria”	do të thotë shoqëria tregtare ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K..
“Çmimi i Blerjes”	do të thotë çmimi në Euro, që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Kuotës siç tregohet në Nenin 3;
“Kuotat e shitura”	do të thotë numri 2 i kuotave të zotëruara, të barabartë me 100% të kapitalit të Shoqërisë, me një vlerë prej prej 5.000,00 (Pesë mijë/00) Euro;
“Vendim i Shoqërisë”	do të ketë kuptimin e Vendimit të marrë nga Shoqëria ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K., nëpërmjet të cilit është miratuar realizimi i këtij operacioni të transferimit të kuotës.

- 1.2 Termat dhe fjalët e përdorura në numrin njëjës në këtë Kontratë do të kenë të njëjtin kuptim dhe në rast se do të përdoren në numrin shumës.
- 1.3 Gjinia mashkullore do të përfshijë edhe gjininë femërore ose asnjëanëse.
- 1.4 Referencat në këtë Kontratë për dispozita/nene dhe anekse janë referenca për dispozitat/nenet e kësaj Kontrate (përveç nëse konteksti kërkon ndryshe).
- 1.5 Titujt vendosen vetëm për arsye lehtësie dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.

NENI 2

OBJEKTI I KONTRATËS

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është transferimi nga Shitësit tek Blerësi, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Kontratë, të Kuotave së zotëruara nga Shitësit dhe çdo të

- drejte që i përket kuotave të lira nga çdo Barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 4;
- 2.2 Kuotat e shitura, objekt i kësaj kontrate përfaqëson përkatësisht masën prej 50% secila dhe sëbashku masën prej 100% të kapitalit të shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K..
- 2.3 Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja janë përgjegjës për të shitur kuotat e përcaktuara më sipër duke qenë se Blerësi është i interesuar për blerjen e tyre në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 3 PËRMBAJTA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K. është themeluar me datë 22/02/2019 dhe regjistruar më datë 25/02/2019 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë me nr. identifikimi NIPT L91425020M. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 5.000,00 (Pesë mijë/00) Euro si më poshtë vijon:

- Znj. Flavieta BALA zotëron 1 (një) kuotë në masën 50% të kapitali themeltar të shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K me vlerë nominale të përgjithshme prej 2.500,00 (dymijë e pesëqind) Euro.
- Z. Marko BRINJA zotëron 1 (një) kuotë në masën 50% të kapitali themeltar të shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K me vlerë nominale të përgjithshme prej 2.500,00 (dymijë e pesëqind) Euro.

Me vendimin e datës 22/11/2019 të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë është vendosur shitja e kuotave në masën 100% nga secili prej Ortakëve të shoqërisë Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja përkatësisht në masën 50% dhe blerja e tyre nga Z. **Z. Greg XHILLARI** në masën 100%.

Shitja e kuotave nga Shitësit, ortakët e shoqërisë Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja, në masën prej 50% të kapitalit themeltar secili dhe sëbashku në masën prej 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K" sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi kuotën e shoqërisë në masën 100% të kapitalit themeltar dhe cilësinë e Ortakut të shoqërisë sipas këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, datë 22/11/2019..

Shitësit, ortakët e shoqërisë Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja, janë plotësisht dakord të shesin me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë të kuotës secili në masën prej 50% të kapitalit që ai zotëron dhe sëbashku në masën prej 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "ECO CAR WASH

ALBANIA SH.P.K". Shitja e kuotave, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit Z. Greg XHILLARI i cili përfiton një kuotë në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Blerësi Z. Greg XHILLARI, është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë kuotën në masën prej 100% të zotëruar nga të dy Shitësit sëbashku në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K..

NENI 4 ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Çmimi i blerjes për Kuotat e shitura të zotëruara nga Shitësit dhe që përfaqësojnë sëbashku 100% të kapitalit është 5.000,00 (Pesë mijë/00) Euro. Çmimi i vendosur nga palët në këtë kontratë përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kuotat e transferuara. Çmimi është fiks dhe i pandryshueshëm.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi **Z. Greg XHILLARI**, do të paguajë në favor të Shitësve Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja, secilit shumën prej 2.500,00 (dymijë e pesëqind) Euro dhe sëbashku shumën në total prej 5.000,00 (Pesë mijë/00) Euro, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

Çmimi i kësaj kontrate do të paguhet në llogarinë bankare të Shitësve me këto të dhëna:

Mbajtës i llogarisë:	Znj. Flavieta BALA
Emri i Bankës:	BANKA KOMBETARE TREGTARE
Numri i	
Iban:	AL5620512644869388CLIDCFEURO
SWIFT:	NCBAALTX

Mbajtës i llogarisë:	Z. Marko BRINJA
Emri i Bankës:	CREDINS BANK
Iban:	AL34 2122 6278 0000 0000 0119 4727
SWIFT:	CDISALTRXXX

NENI 5 MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, Ortakët e shoqërisë Znj. Flavieta Bala dhe Z. Marko Brinja, humbasin pronësinë mbi kuotën përkatësisht secili në masën 50%, të kapitalit themeltar

dhe sëbashku 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K. dhe cilësinë e ortakut në shoqëri, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi pjesën e shitur të kuotave në masën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Ndërsa Blerësi Z. Greg Xhillari, bëhet pronar i kuotës së shitur përkatësisht në masën prej 100% të kapitalit të shoqërisë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e kësaj kuote.

Shoqëria Tregtare "ECO CAR WASH ALBANIA" Sh.p.k., pas realizimit të këtij operacioni shit-bletje kuote, sipas kësaj kontrate dhe me regjistrimin e kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar, do të ketë si ortakë të saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- **Z. Greg Xhillari, zotëron një kuotë në masën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA Sh.p.k. me vlerë nominale prej 5.000,00 (Pesë mijë/00) Euro.**

NENI 6

DETYRIMET E PALËVË NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN

Përveç ndonjë veprimi tjetër për tu ndërmarrë dhe të ndonjë instrumenti tjetër për t'u nënshkruar dhe/ose dorëzuar në përputhje me këtë Kontratë, për transferimin e kuotës në datën e transferimit:

a) Shitësi do të:

- Nënshkruajë dhe dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e instrumentave të tjera që mund të jenë të nevojshme siaps legjislacionit shqiptar, për t'i kaluar Blerësit pronësinë e lirë nga çdo barrë apo pretendim të çdo lloji, qoftë nga përsona fizik apo juridik, privatë apo publikë.

Dhe

b) Blerësi do të:

- Paguajë të plotë çmimin e Blerjes në shumën e caktuar në nenin 4 të kësaj Kontrate;
- Fitojë titullin mbi Kuotën në Datën e Transferimit dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to duke filluar nga Dara e Transferimit.

NENI 7

LIGJI QË DO TË ZBATOHET



7.1 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit tregtar dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

7.2 Zgjidhja e Konfliktëve

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të palëve në këtë kontratë. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 8

TË NDRYSHME

8.1 Ndryshimet e kontratës

Çfarëdolloj modifikimi ose ndryshimi i kësaj Kontrate ose i klauzolave të saj ose heqje dorë nga zbatimi i çfarëdolloj klauzole të kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme dhe detyruese për Palët nëse nuk rezulton nga një akt i shkruar i firmosur nga të dyja Palët.

8.2 Njoftimet

Njoftimet e nevojshme ndërmet palëve duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të konsiderohen të dhëna efektivisht (i) përmes dërgimit jo në rrugë postare në qoftë se dorëzohen personalisht (ii) përmes dërgimit në rrugë postare rekomande në qoftë se dorëzohen nga korrieri dhe vërtetohet marrja;

Dërgimet ose njoftimet kryehen në adresat që palët do t'i komunikojnë njëra-tjetrës.

NENI 9
ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëngjiten si anekse që cilat do konsiderohen pjesë integrale dhe të pandashme të saj dokumentat e mëposhtme:

- Vendimi i Shoqërisë ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K.
- Ekstrati i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale, nga të cilat një e mban shitësi, një blerësi, një kopje depozitohet në QKR, një kopje mbahet nga shoqëria dhe është nënshkruar nga të dyja palët pa asnjë rezervë.

PALËT

SHITËSIT

Flavieta BALA



Marko BRINJA



BLERËSI

Greg XHILLARI

